VENDIM
Nr. 127, datë 20.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 934, DATË 26.12.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2013, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 11 të ligjit nr. 119, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 934, datë 26.12.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 941 punonjës. Shtesa prej 9 (nëntë) punonjësish është dhënë me hollësi sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të institucionit, për vitin 2013.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore, sipas lidhjes nr. 1 të pikës 1 të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave të dhëna të hollësishme për numrin e punonjësve në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha